Auditimi perfshin kryerjen e procedurave per sigurimin e te dhenave te auditimit per shumat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura jane ne gjykim te audituesit, duke perfshire vlersimin e rrishtit te anomalive materiale si rezultat i gabimeve ose pasaktesirave. Gjate vleresimit te ketyre rreziqeve, audituesi merr ne konsederate kontrollin e brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te Pasqyrave Financiare ne menyre qe te percaktoje procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme per



ALBANIAN AUDIT AND INTERNATIONAL PARTNERS

Adresa Rr. Kajo KARAFILI
Pall. BIMBASHI Ap.3/D
Tirane, Albania

Phone: (+355 4) 223 7171
Fax: (+355 4) 223 7181
email: b_shtrepi@yahoo.com

rrethanat financiare, por jo per qellim te shprehjes se nje opinioni per efektivitetin e kontrollit te brendshem te shoqerise. Auditimi perfshin gjithashtu vleresimin e pershtatshmerise se parimeve kontabile te perdorura dhe pranueshmerine e cmuarjeve kontabile te kryera nga drejtimi, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te Pasqyrave Financiare. Auditimi perfshin gjithashtu, vleresimin e parimeve kontabel te perdorura dhe te cmuarjeve te rendesishme te bera nga Drejtimi, si edhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te Pasqyrave Financiare.

Ne besojme se te dhenat e auditimit qe ne kemi siguruar jane te mjaftueshme dhe te pershtatshme per te bazuar opinionin tone.

Opinion

Sipas opinionit te Ekspertit Kontabel te Rregjistruar, Pasqyrat Financiare te Shoqerise « ERDA» Sh.p.k., japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte te gjendjes financiare te Shoqerise me date 31 Dhjetor 2010, si dhe te rezultateve te veprimtarive te saj per ushtrimin e mbyllur, ne pajtim me Standartet Kombetare te Kontabilitetit dhe respektojne Ligjin nr 9228 date 29 04 2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar..

Me respekt
Fatbardha SHTREPI

Ekspert Kontabel i Rregjistruar

Tirane, me 17 Mars 2011



Fatbardha SHTREPI
Auditor e Licensuar

Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2010

AKTIVET

Nr. Ref.	AKTIVET	Viti Ushtrimor	
		31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
I	Aktive Afatshkurtra	14,551,228	6,562,566
1	Mjetet Monetare	1,180,741	1,398,766
2	Derivate dhe Aktive Financiare te mbajtur per tregtim	-	-
a)	Derivatet	-	-
b)	Aktivet e mbajtur per tregtim	-	-
	Totali 2	-	-
3	Aktive te tjera Financiare afatshkurter	3,840,141	3,802,059
a)	Llogari kerkesa te arketueshme	757,178	263,824
b)	Llogari kerkesa te tjera te arketueshme	3,082,963	3,538,234
c)	Instrumente te tjera borxhi	-	-
d)	Investime te tjera financiare	-	-
	Totali 3	3,840,141	3,802,059
4	Inventari	9,530,345	1,345,491
a)	Lendet e para	9,530,345	982,487
b)	Prodhimi ne proces	-	-
c)	Materiale Promocioni	-	-
d)	Mallra per rishitje	-	363,004
e)	Parapagesat per furnizime	-	-
	Totali 4	9,530,345	1,345,491
5	Aktive Biologjike afatshkurter	-	-
6	Aktive Afatshkurtra te mbajtur per shitje	-	-
7	Parapagime dhe shpenzime te shtyra	-	16,250
	Total i Aktiveve Afatshkurtra	14,551,228	6,562,566
II	Aktive Afatgjata	122,653,464	121,089,585
1	Investime financiare afatgjata	-	-
a)	Aksione dhe pjesemarrje te tjera ne njesi te kontrolluara	-	-
b)	Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje	-	-
c)	Aksione dhe letra te tjera me vlere	-	-
ç)	Llogari kerkesa te arketueshme	-	-
	Totali 1	-	-
2	Aktive Afatgjata Materiale	122,653,464	121,089,585
a)	Toka	16,000,000	16,000,000
b)	Ndertesa (neto)	12,563,036	12,563,036
c)	Makineri dhe pajisje (neto)	93,050,183	91,609,683
ç)	Aktivite te tjera afatgjata materiele (neto)	1,040,245	916,865
	Totali 2	122,653,464	121,089,585
3	Aktive Biologjike Afatgjate	-	-
4	Aktive Afatgjata Jomateriale	-	-
a)	Emri i mire	-	-
b)	Shpenzimet e zhvillimit	-	-
c)	Aktive te tjera afatgjata jomateriele	-	-
	Totali 4	-	-
5	Kapitali aksionar i papaguar	-	-
6	Aktive te tjera afatgjata (ne proces)	-	-
	Totali i Aktiveve Afatgjata	122,653,464	121,089,585
	TOTALI AKTIVEVE	137,204,693	127,652,151

Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2010

DETYRIMET DHE KAPITALI

Nr. Ref.	DETYRIMET DHE KAPITALI	Viti Ushtrimor	
		31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
I	Detyrimet Afatshkurta	14,508,932.29	1,198,347.00
1	Derivatet		
2	Huamarrjet	11,984,943.13	-
a)	Huate dhe obligacionet afatshkurtra	11,984,943.13	-
b)	Kthimet/Ripagimet e huave afatgjata	-	-
c)	Bono te konvertueshme	-	-
	Totali 2	11,984,943.13	-
3	Huate dhe parapagimet	2,523,989.16	1,198,347.00
a)	Te pagueshme ndaj furnitoreve	994,836.43	535,474.00
b)	Te pagueshme ndaj punonjesve	-	-
c)	Detyrimi me tatimore	1,529,152.73	542,873.00
ç)	Hua te tjera	-	120,000.00
d)	Parapagimet e arketueshme	-	-
	Totali 3	2,523,989.16	1,198,347.00
4	Grantet dhe te ardhura te shtyra		
5	Provizionet afatshkurtra		
	Detyrime Totale Afatshkurtra	14,508,932.29	1,198,347.00
II	Detyrimet Afatgjata	102,951,695.18	103,583,774.91
1	Huate afatgjata	-	-
a)	Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare	-	-
b)	Bonot e konvertueshme	-	-
	Totali 1	-	-
2	Huamarrje te tjera afatgjata	102,951,695.18	103,583,774.91
3	Provizionet afatgjata	-	-
4	Grandet dhe te ardhura te shtyra		
	Detyrime Totale Afatgjata	102,951,695.18	103,583,774.91
	Detyrime Totale	117,460,627.47	104,782,121.91
III	Kapitali	19,744,065.43	22,870,028.92
1	Akisonet e pakices		
2	Kapitali i aksionereve te shoqerise meme		
3	Kapitali i aksionar	22,000,000.00	27,652,016.00
4	Primi i aksionit		
5	Njesite ose aksionet e thesarit		
6	Rezerva statutore		
7	Rezerva ligjore	870,029.00	407,559.00
8	Rezerva te tjera	-	-
9	Fitimi i pashperndare	-	-
10	Fitimi (humbje) e vitit financiar	(3,125,963.57)	(5,189,546.08)
	Totali i Kapitalit	19,744,065.43	22,870,028.92
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT	137,204,692.90	127,652,150.83

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
(Bazuar në klasifikimin e Shpenzimeve sipas Natyrës)


Nr. Ref.	Pershkrimi	Viti Ushtrimor	
		31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
	Te Ardhurat	110,868,861.06	82,638,103.82
1	Shitjet neto	111,231,864.62	82,617,110.26
2	Të ardhura të tjera		-
3	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	(363,003.56)	20,993.56
4	Materialet e konsumuara	(68,314,846.88)	(64,424,099.14)
5	Kosto e punës	(14,929,476.52)	(12,657,690.38)
a)	pagat e personelit	(12,823,348.00)	(10,748,798.00)
b)	shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	(2,106,128.52)	(1,908,892.38)
c)	shpenzimet per honorare	-	-
6	Amortizimet dhe zhvlerësimet		
7	Shpenzime të tjera	(29,265,326.36)	(9,935,161.61)
8	Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)	(112,509,649.76)	(87,016,951.13)
9	Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)	(1,640,788.70)	(4,378,847.31)
10	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e		
11	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		-
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	(229,903.94)	(796,957.16)
12/a	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të		
12/b	Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	(344,793.39)	(603,344.31)
12/c	Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	1,438.45	(1,301,448.85)
12/d	Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	113,451.00	1,107,836.00
13	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (12.1+/-12.2+/-12.3+/-12.4)	(229,903.94)	(796,957.16)
	Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)	(1,870,692.64)	(5,175,804.47)
14	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	(1,255,270.93)	(13,741.60)
15	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)	(3,125,963.57)	(5,189,546.07)

PASQYRA E FLUKSIT MONETAR
(Metoda direkte)

Nr. Ref.	Fluksi Monetar	Viti Ushtrimor	
		31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
I			
1	Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit	(7,749,606)	(10,294,247)
a)	Mjetet monetare (MM) të arkëtuara nga klientët	132,984,883	98,876,705
b)	MM të paguara ndaj furnitorëve, punonjësve dhe taksa	(139,701,138)	(107,970,952)
c)	MM të ardhura nga veprimtaritë	113,451	-
d)	Interesi i paguar	(346,802)	-
e)	Tatim mbi fitimin i paguar	(800,000)	(1,200,000)
	<i>MM neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit</i>	<i>(7,749,606)</i>	<i>(10,294,247)</i>
2	Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese	(2,101,863)	22,096,807
a)	Blerja e njësisë së kontrolluar X minus paratë e Arkëtuara		
b)	Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(2,103,876)	(18,203,555)
c)	Të ardhurat nga shitja e pajisjeve		
d)	Interesi i arkëtuar	2,012	-
e)	Dividendët e arkëtuar		40,300,361
	<i>MM neto të përdorura në veprimtaritë investuese</i>	<i>(2,101,863)</i>	<i>22,096,807</i>
3	Fluksi monetar nga aktivitetet financiare	9,633,445	(11,815,648)
a)	Të ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar	-	-
b)	Të ardhura nga huamarrje afatgjata (Ortaku)	(1,277,266)	-
c)	Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare (Kredi)	11,984,943	(11,815,648)
d)	Dividendë të paguar Ortaku	(1,074,232)	-
	<i>MM neto e përdorur në veprimtaritë financiare</i>	<i>9,633,445</i>	<i>(11,815,648)</i>
4	Rritja/rënia neto e mjeteve monetare	(218,025)	(13,089)
5	Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	1,398,766	1,411,854
6	Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	1,180,741	1,398,766
		1,180,741	1,398,766

PASQYRA E LEVIZJES SE KAPITALIT
(b) Në një pasqyrë të pakonsoliduar

Levizja e Kapitaleve	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione të thesarit	Rezerva ligjore statusore	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 dhjetor 2008	27,652,016.00			392,273.00	298,285.60	28,342,574.60
Efektet e marrësiveve në politikat kontabël						
Pozicioni i rregulluar						
Fitimi neto për periudhën kontabël					-	
Dividendët e paguar						
Rritje e rezervës së kapitalit						
Emetimi i aksioneve						
Pozicioni më 31 dhjetor 2009	27,652,016.00	-	-	407,559.00	(5,189,546.08)	22,870,028.92
Fitimi neto për periudhën kontabël						
Dividendët e paguar						
Rritje e rezervës së kapitalit						
Aksione të thesarit të riblera						
Pozicioni më 31 Dhjetor 2010	22,000,000.00	-	-	870,029.00	(3,125,963.57)	19,744,065.43



Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2010

I. TE DHENA TE PERGJITHSHME MBI SHOQERINE

Shoqeria “E R D A” sh.p.k., eshte nje Shoqeri e krijuar sipas vendimit te Gjykates Nr 10818 , me 17 Maj 1995 me seli ne qytetin e Tiranes .

Krijimi i kesaj shoqerie eshte bazuar ne ligjin Nr.7638 Dt.19.11.1992 dhe ligjit Nr.7667, Dt. 28.01.1993 perkatesisht “Per shoqerite tregtare “ dhe ” Per rregjistrin tregtar”. Administrator i shoqerise ne krijimin e saj eshte z. Kujtim OSMANI . Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave te ligjit Nr.9901 dt. 14.04.2010 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” si dhe nga Statuti i saj.

“E R D A ” sh.p.k.,eshte nje shoqeri vendase qe ne krijimin e saj kishte dy ortake: z. Kujtim OSMANI shtetas Shqiptar i cili zoteron 50% te kuotave te kapitalit te shoqerise, z. Kujtim BAHOLLI shtetas Shqiptar i cili zoteron 50% te kuotave te kapitalit te shoqerise

Ajo eshte regjistruar prane organeve tatimore te rrethit Tirane me NIPT J 61903058 U.

Objekt Veprimtarise se Shoqerise eshte Prodhim i Produkteve te Mishit dhe Sallameve te ndryshme si dhe Tregtimi i tyre.

Aktiviteti i shoqerise eshte parashikuar te zhvillohet ne nje afat kohor mbi 10 vjete.

a) Kapitali dhe pronësia

Kapitali i Shoqerise “E R D A” sh.p.k., ne momentin e krijimit te saj eshte 100,000 leke i ndare ne 100 pjese me vlere nominale 1,000 leke secila.. Kapitali i nenshkruar ka pesuar ndryshime duke u rritur nga fitimet e mbartura deri ne mbyllje te vitit 2008. Rritja e kapitalit eshte bere me vendimin e Asamblese se Otakeve duke e cuar vleren e kapitalit te nenshkruar ne 27 652 016 leke. Gjate vitit 2010 kaitali i shoqerise eshte zvogeluar me vleren e humbjeve te mbartura deri ne vitin 2009 duke shkuar ne vlerat e 22 000 000 leke e ndare ne 100 pjese me vlere nominale 220 000 leke sejcili.Ky kapital zoterohet teresisht nga persona private nga zoti Kujtim Osmani.

Ndryshimet ne kapitalin e nenshkruar jane bere me Vendim Gjykate e jane regjistruar ne Q.K.R.

Shoqeria “E R D A” sh.p.k., vendimit te Gjykates Nr 10818/1 , me 22 korrik 2003 ka bere ndryshime duke e kaluar pronesine e shoqerise ne emer te z.Kujtim OSMANI i cili behet zoterues i 100% i kapitalit te shoqerise,dhe Ndryshimet pronesise jane regjistruar ne Q.K.R.


b) Administrimi

Struktura organike, Administrimi, Organizimi, Drejtimi i pershtaten natyres se Shoqerise dhe realizimit te objektit të veprimtarisë së saj. Shoqeria Drejtohet nga Administratori. Administrator i Shoqerise eshte z.Ergest OSMANI.

II. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABEL

a. Menyra e Pregatitjes se Pasqyrave Financiare

Pasqyrat Financiare te shoqerise jane pregatitur ne te gjitha aspektet e tyre materiale, ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK), te cilat perfshijne rregullat e percaktuara ne ligjin Nr. 9228 date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” i ndryshuar me ligjin 9477 date 09.02.2006 per “Standartet Kombetare te Kontabilitetit” (SKK) te miratuar me vendim te Keshillit te Ministrave. Pasqyrat Financiare jane pregatitur duke ndjekur e zbatuar **Politikat Kryesore Kontabel** si : politika per njohjen e aktiveve,per njohjen e detyrimeve ,njohjen e te drejtave ,njohjen e te ardhurave e



Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2010

shpenzimeve si dhe njohjen dhe vleresimin e tyre. Gjithashtu gjate pergatitjes se Pasqyrave Financiare jane pasur parasysh **Parimet** informacionit: si Parimi i te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara, Parimi i Njesise Ekonomike Raportuese, Parimi i vijimesise se veprimtarise ekonomike si dhe Parimi i Kompesimit. **Karakteristikat** cilesore te pergatitjes se Pasqyrave Financiare jane ato qe e bejne informacionin e pasqyrave financiare te dobishem per perdoruesin. Karakteristikat kryesore qe jane mbajtur parasysh gjate hartimit te Pasqyrave Financiare te vitit 2008 jane :Kuptueshmeria, Rendesia dhe Materialiteti, Besueshmeria,, Parimi I Paraqitjes me Besnikeri parimi i Perparemise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore, Paanshmeria, Parimi i maturise, Parimi i plotesise. Qendrushmeria dhe Krahasueshmeria. Pasqyrat financiare te shoqerise jane pregatitur mbi bazen e kostos historike. Pasqyrat e paraqitura ne raport jane shprehur ne monedhen vendase ne Leke. E vecanta e ketij viti ushtrimor eshte hyrja ne fuqi e Ligjit nr 9228 date 29.04.2004. i ndryshuar me Ligjin nr 9477 date 09.02.2006 per “Standartet Kombetare te Kontabilitetit” (SKK) te miratuar me vendim te Keshillit te Ministrave SKK nr 2 si i vetmi format ligjor i raportimit

b. Rregullat per vleresimin Mjeteve Monetare

Mjetet monetare perfaqesojne Likuiditetet e njesise ekonomike ne arke dhe ne banke ,ne llogari rrjedhese ,investime ne tregun e parase dhe tregje te tjera shume likuide duke ndjekur politiken kontabel te *Vleres se drejte* ne zbatim te SKK 3

i. Veprimet me monedha te huaja

Regjistrimet e transakcioneve ne monedhe te huaj, regjistrohen ne kontabilitet me kursin e datës së kryerjes së transakcionit. *Gjendjet e likuiditeteve*, ne monedhe te huaj ne datën e mbylljes së bilancit janë të vlerësuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2009. Diferencat respektive janë reflektuar në llogaritë e rezultatit.

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Kurset e Kembimit	-	-
Euro/Leke	138.77	137.96
Usd/Leke	104.00	95.81
Chf/Leke	110.98	93.04
Gbp/Leke	161.46	154.64

c. Rregullat per vleresimin e Aktiveve te tjera financiare afatshkurtera

Aktiveve te tjera financiare afatshkurtera ,kerkesa te arketueshme afatshkurtera letra me vlere dhe investime te tjera financiare jane te pasqyruara mbi bazen e vleres se faturave origjinale te leshuara klienteve apo te dokumentave te tjere kontabel. Politika kontabel e ndjekur per aktivet financiare afatshkurtera eshte sipas *Kostos se amortizuar (ne pergjithesi eshte e barabarte me vleren nomonale te kerkeses per arketim minus zhvleresimin n.q.s. ka)* sipas SKK 3.

Detyrimet jane njohur dhe pasqyruar ne Pasqyrat Financiare mbi bazen e faturave dhe dokumentave orgjinale kontabel.

Llogaritë e Aktiveve te tjera financiare afatshkurtera në monedhë të huaj, në datën e mbylljes së bilancit janë të vlerësuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2009. Diferencat respektive janë të reflektuar në llogaritë e rezultatit.

Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2010

d. Rregullat per vleresimin e Gjendjeve te Inventarit.

Gjendjet e inventarit klasifikohen ne Lende te para ,Pridhim ne proces,Produkte te gatshme e Mallra per rishitje,Parapagesa per rishitje. Politika e ndjekur eshte ajo e *Vleresimit me vleren me te ulet mes kostos dhe vleres neto te realizueshme.Kosto eshte llogaritur per cdo ze duke perdorur metoden FIFO* ne zbatim te SKK 4. Menyra e Vleresimit te Inventareve permbledh shpenzimet e blerjes se lendeve te para,mallrave e materialeve ,shpenzimet e transportit,shpenzimet ne dogane,shpenzimet e ngarkimshkarkimit e shpenzimet e tjera deri ne magazinimin e tyre.

Shoqeria per ndjekjen e gjendjes se stokut ka perdur metoden e inventarit te perhereshem.

e. Rregullat per vleresimin e Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra perfaqesojne shpenzimet e bera gjate vitit financiar por qe u perkasin periudhave te ardhshme te njesise ekonomike.Per to eshte ndjekur politika kontabel *kosto minus zhvleresimin nqs ka te tille*, pasqyruar sipas percaktimit e ne zbatim te SKK 1.

f. Rregullat per vleresimin e Aktiveve Afatgjata

Aktive Afatgjata Materiale e Jomateriale paraqiten ne bilanc me vleren e tyre neto.

Aktive Afatgjata Jomateriale te ndara ne zeratsi Emri i mire,Shpenzimet e nisjes e zgjerimit e Aktive te tjera Jomateriale te klasifikuara sipas SKK 5 jane perfshire ne pasqyrat financiare duke ndjekur politiken kontabel *Kosto e blerjes ose prodhimit ose shuma e rivleresuar minus amortizimin e akumuluar dhe zhvleresimin nqs ka*.


Aktivet Afatgjata Materiale te ndara ne zerat si toka,ndertesa,makineri e paisje,paisje zyre e informatike te klasifikuara sipas SKK 5 jane perfshire ne pasqyrat financiare duke ndjekur politiken kontabel *Kosto e blerjes ose prodhimit ose shuma e rivleresuar minus amortizimin e akumuluar dhe zhvleresimin nqs ka*.Metoda e llogaritjes se Amortizimeve behet ne zbatim te ligjit nr 8438 date 28 12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar.Baza e llogaritjes se amortizimeve behet mbi vleren neto kontabel.Llogaritja e amortizimit per Aktivet Afatgjata Materiale e Jomateriale te hyra gjate vitit eshte bere duke filluar nga data 1 e muajit pasardhes.

g. Rregullat per vleresimin e Huamarrjeve Afatshkurtera

Ne huamarrjet afatshkurtera jane klasifikuar hua,bono,mbiterheqje dhe hua te tjera afatshkurtera (deri ne 12 muaj) te marra per qellime financimi,si dhe pjesa e huave dhe detyrimeve te qerases financiare qe do te paguhen brenda 12 muajve te ardhshem te klasifikuara sipas SKK 3 dhe SKK 7 duke ndjekur politiken kontabel te *Kostos se amortizuar*.

h. Rregullat per vleresimin e Huave e Parapagimeve

Huate dhe parapagimet te klasifikuatra sipas zerave te pagueshme ndaj furnitoreve,ndaj punonjesve,detyrime tatimore,hua te tjera jane vleresuar sipas faturave te blerjes e dokumentave te tjere origjinale kontabel.Politika e ndjekur eshte ne baze te *Kostos se amortizuar* ne zbatim te SKK 3.



Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2010

i. Rregullat per vleresimin e Huamarrjeve Afatgjata

Ne huamarrjet afatgjata jane klasifikuar hua,bono,mbiterheqje dhe hua te tjera afatgjata (mbi12 muaj) te marra per qellime financimi,si dhe pjesa e huave dhe detyrimeve te qerases financiare qe do te paguhen pas 12 muajve te ardhshem te klasifikuara sipas SKK 3 dhe SKK 7 duke ndjekur politiken kontabel te *Kostos se amortizuar*.

j. Rregullat per vleresimin e Kapitalit

Kapitali i njesise ekonomike vleresohet sipas vleres kontabel te kapitalit aksionar te emetuar ne krijim te njesise ekonomike,rezervave te krijuara ne perputhje me statutin e njesise ekonomike,ne perputhje me kerkesat e ligjit “Per shoqerite Tregtare” ose ndonje ligj tjetër te aplikueshem,Fitimet e pashperndara qe perbehet nga fitimet e akumuluar minus pagesat e bera ose te perdorura.Fitimet e pashperndara te ndikuara nga ndikimet ne politikat kontabel (SKK 1) korigjimi i gabimeve si dhe rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale(SKK 5).Fitimi ose humbja e vitit financiar e barabarte me fitimin ose humbjen e raportuar ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve.

k. Rregullat e vleresimit te te Ardhurave


Te ardhurat perfaqesojne shitjet neto e rrjedhimisht te ardhurat e perftuara nga shitja e produkteve,mallrave e sherbimeve gjate periudhes kontabel te vleresuara sipas SKK 8. Ato rregjistrohen sipas mases se realizimit te tyre dhe te lidhjes qe kane me ushtrimin e mbyllur kontabel, pamvaresisht nese arketimi i tyre apo i nje pjese prej tyre do te ndodhe ne nje ushtrim pasardhes.

l. Rregullat e vleresimit te Shpenzimeve Direkte

Shpenzimet e njesise ekonomike te vitit financiar perfaqesojne shpenzimet e blerjes se mallrave,lendeve te para dhe sherbimeve te konsumuara per veprimtarine paresore ,koston e sherbimeve kryesore te vlersuara me cmimet e blerjes e te vertetuara me fatura origjinale e dokumenta te tjera kontabel,shpenzime qe lidhen ne menyre direkte me mallrat ose produktet e destinuar per shitje.Pagat shperblimet dhe kompesimet monetare ,sigurimet shoqerore te paguara nga njesia ekonomike te llogaritura mbi pagat qe i perkasin periudhes kontabel pamvaresisht nga fakti nese ato jane paguar ose jo.Shpenzimet per amortizimin qe vijne nga renia ne vlere e aktiveve afatgjata.Shpenzimet e tjera qe jane shpenzimet e pa perfshira ne zerat e mesiperem por qe lidhen me veprimtarine kryesore te njesise ekonomike.

m. Rregullat e vleresimit te Shpenzimeve (Te Ardhurave) Financiare

Te ardhurat ose shpenzimet financiare jane klasifikuar ne te ardhura ose shpenzime nga interesat bankare, te ardhura (shpenzime) te interesi mbi huate, bono, marreveshje te qerases financiare etj.Te ardhura (shpenzime) nga ndryshimi i kursit te kembimit, te kerkesave per tu arketuar dhe detyrimeve per tu paguar si dhe gjendjet e likuiditeteve ne monedhe te huaj qe lidhen me veprimtarine financiare e investuese ne fund te periudhes financiare. Te ardhura te tjera (shpenzime) financiare si rezultati nga financimet financiare afatshkurtera,rezultati nga interesi dhe dividendet,rezultati nga rivleresimi i vleres se drejte etj



Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2010

n. Rregullat e vleresimit te Tatimi mbi Fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin vleresohen ne baze te rezultatit te periudhes financiare i llogaritur ne perputhje me dispozitat per tatimin mbi te ardhurat ne Republiken e Shqiperise. Shpenzimet per tatimin mbi fitimin perfshije gjithe detyrimet per tatimin mbi fitimin e periudhes financiare. Shkalla tatimore ne fuqi per tatimin mbi fitimin eshte 10%.

o. Rregullat e vleresimit te Fondit te pensioneve

Shoqeria paguan kontributet per pensione si edhe kontribute per sigurim shendetsor per punonjesit e saj sic eshte parashikuar nga legjislacioni social vendas. Kontributet, bazuar ne pagat, jane paguar ne llogari te organizmave kombetare pergjegjes per pagesen e pensioneve dhe shpenzimeve shendetsore.

III. ORGANIZIMI I KONTABILITETIT

Kontabiliteti eshte i organizuar ne perputhje me ligjin nr 9228 date 29 04 2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” i ndryshuar me ligjin nr 9477 date 09.02.2006 dhe me SKK 2 , Shoqeria ka ndertuar nje plan te llogarive vetjake ne perputhje e ne zbatim te SKK te miratuar me vendim te Keshillit te Ministrave.

Departamenti i Finances perbehet nga 2 persona specialiste finance. Kontabiliteti mbahet ne menyre te informatizuar nepermjet programeve baze te kontabilitetit FINANCA 5.

IV. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE

